



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2021:231948

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05794213

**P.nr.364/21**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal**, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me procesmbajtësen Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurës F.Sh, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par. 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.955/21 e datës 30.11.2021, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar më datë **22.04.2024**, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Sadije Muriqi dhe të pandehurës F.Sh, të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 20.05.2024, përpiloi, këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **E pandehura:**

**F.Sh**, nga i ati Sh. dhe e ëma I., e lindur me datë ... në Fushë Kosovë, tani me vendbanim në fshatin S., Komuna e I., e martuar, nënë e katër fëmijëve, nuk ka të kryer shkollim, nuk din shkrim dhe lexim, e pa punë, e gjendjes së dobët ekonomike - përfituese e asistencës sociale, me numër personal ..., egjiptiane, shtetase e Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTORE**

#### **Sepse:**

Më datën 24.04.2021, rreth orës 13:00, në fshatin S., Komuna Istog, afër shtëpisë së të dëmtuarës A.Z, me dashe e me mjet qe mund të shkaktoj lëndim të rëndë trupor apo dëmtim të rëndë të shëndetit, i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarës, në atë mënyrë qe deri sa e dëmtuara po bisedonte me E.M-bashkëshortin e të pandehurës, e pandehura, për një moment me një shkop prej druri e godet në këmbën e majtë të dëmtuarën, e si pasojë e goditjeve, sipas ekspertizës mjeko-ligjore të punuar për rastin, të dëmtuarës i shkakton lëndime të lehta trupore, me dëmtim të përkohshëm te shëndetit.

- me çka ka kryer veprën penale **lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 nën par.1.4 të KPRK-së.**

Gjykata duke u bazuar në nenin e lartcekur dhe dispozitat e nenit 2, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42,46, 47, 48, 49, 69, 79 të KPRK-së dhe nenit 242, 364, 459 të Kodit të Procedurës Penale (tutje KPP-së), të pandehurës i shqipton:

## DËNIM ME KUSHT

- I.** Ashtu që, të pandehurës F.Sh, i shqiptohet dënimi më burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, *i cili dënim do të jetë i kushtëzuar, nuk do të ekzekutohet*, nëse e pandehura brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
  - **Në të kundërtën**, nëse e pandehura brenda periudhës së lartcekur të verifikimit kryen vepër tjetër penale, atëherë gjykata në bazë të nenit 50 të KPRK-së, do t'a revokon dënimin me kusht dhe ndaj personit të dënuar do të ekzekutohet dënimi me burgim.
- II.** E pandehura lirohet në tersi nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale.
- III. Pala e dëmtuar:** A.Z nga fshati S., Komuna I., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

## A r s y e t i m

### Rrjedha e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.955/2021 e datës 30.11.2021, kundër të pandehurës F.Sh për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, dhe të pandehurës A.Z për shkak të veprës penale lajmërimi apo kallëzimi i rremë nga neni 328 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 22.04.2024 në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Sadije Muriqi dhe e pandehura F.Sh, ndërsa nuk ka prezantuar e pandehura A.Z, e cila ka qenë e pa arritshme siç konstatohet edhe në raportin e policisë të datës 17.04.2021. Prokurori i shtetit, për shkak të mos prezencës se te pandehurës A.Z dhe për shkak të efikasitetit te procedurës, ka propozuar që të veçohet procedura penale ndaj saj pasi qe edhe veprat penale nga të pandehurat nuk janë kryer në bashkëkryerje. Lidhur me këtë propozim është pajtuar edhe e pandehura F.Sh. Gjykata pasi ka dëgjuar palët prezentë dhe pas vlerësimit të kushteve ligjore dhe shqyrtimit të shkresave të lënës në pajtim me

nenin 35 të KPP-së, ka vendosur që të bëhet veçimi i procedurës penale ne raport më të pandehurën A.Z për veprën penale lajmërimi apo kallëzimi i rremë nga neni 382 par. 1 të KPRK-së e cila i vihet në barrë, e cila lëndë e veçuar ndaj saj do te evidentohet me numër të ri të lëndës.

Ndërsa sa i përket te pandehurës F.Sh, ka vazhduar procedura me numrin ekzistues të lëndës, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata pasi që është bindur se e pandehura e ka kuptuar akuzën, dhe pas njoftimit me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, i ka mundësuar të pandehurës të deklarohet për pranimin e fajësisë apo të deklarohet e pafajshme.

**E pandehura F.Sh**, ka deklaruar se: e pranon fajësinë për shkak të veprës penale për të cilën akuzohet, është e vetëdijshme për pasojat e pranimit të fajësisë pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se është penduar për këto veprime dhe i premtom gjykatës se ne të ardhmen do të këtë sjellje të mira dhe nuk do të kryej vepra penale.

**Prokurori i shtetit**, lidhur me pranimin e fajësisë nga e pandehura, ka deklaruar: pajtohem me pranimin e fajësisë të deklaruar nga ana e të pandehurës për veprën penale e cila i bije në barrë, e njëjta është bërë në mënyrë vullnetare nga e pandehura, pa ndonjë presion, me vetëdije të plotë duke i kuptuar benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe gjen mbështetje edhe në shkresat e lëndës.

#### Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata ne rastin konkret lidhur me pranimin e fajësisë nga e pandehura, pas marrjes së mendimeve të lartcekura, si dhe pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 1, 2, nën par. 2.1, 2.2, dhe 2.3 të KPP-së, përkatësisht pas vlerësimit se e pandehura e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 242 par. 2, nën par. 2.4 të KPP-së, gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë nga e pandehura për veprën penale të lartcekur për te cilën është akuzuar.

#### Vendimi për shpalljen fajtor

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të pandehurën t'a shpall fajtores për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se e njëjta është penalisht përgjegjëse dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të te pandehurës, po ashtu në veprimet e saj manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale të lartcekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas pranimit të fajësisë nga e pandehura dhe konstatimit nga gjykata të përmbushjes se kushteve ligjore, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

#### Rrethanat që janë marre për bazë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat

konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se e pandehura e ka pranuar fajësisë dhe rrethanat personale se është penduar për këto veprime, moshën e saj të re dhe se është nënë e katër fëmijëve të mitur për të cilët kujdeset; ndërsa **rrethana rënduese** nuk ka gjetur. Prandaj, në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura, gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit si në dispozitiv të aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e këtu të pandehurit, i cili do ta kuptoj rëndësinë e veprës penale të cilën e ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektoj që në të ardhmen mos të shkaktoj veprime të ndaluara- përkatësisht mos të kryej vepër penale, si dhe do të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura në afat prej një (1) viti, nga dita kur ky aktgjykim merr formën e prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurës, me të cilin dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit me kusht sipas nenit 47 të KPRK-së, përkatësisht që të mos zbatohet dënimi për vepra penale kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e mjaftueshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Gjykata, të pandehurës me anë të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim, i'a tërheq vërejtjen seriozisht dhe i bëhet me dije se nëse kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës kohore të verifikimit, dënimi i cili ka qenë i kushtëzuar për një kohë të caktuar, do të ekzekutohet.

#### Shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 452 par. 4 të KPP-së, e liroj të pandehurën nga shpenzimet e procedurës për faktin se e njëjta, është me gjendje të dobët ekonomike, e pa punë, përfituese e asistencës sociale dhe se pagesa e këtyre shpenzimeve do të i'a rrezikonte gjendjen e saj materiale dhe të familjes së saj, për të cilët ka detyrim të kujdeset.

#### Udhëzimi i palës së dëmtuar për kërkesat pasurore-juridike

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, është marr konform nenit 462 par.2 të KPP-së.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neneve 242, 364 dhe 369 të KPP-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**

**Procesmbajtësja**  
**Hale Ahmetaj**

---

**GJYQTARI**  
**Petrit Nrecaj**

---

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, *në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.*